SHABAN ÇUPI

ARMIKU NA KA NË DORË VETËM AQ SA E LEJOJMË NE VET

Të kthehesh 45 vite mbrapa, don të thotë të kthehesh në një botë tjetër, të kthehesh në një sistem tjetër shoqëroro-politik, në këtë rast në sistemin monist jugosllav ku fjala e lirë sanksionohej me ligj e si pasojë të priste edhe burgu.

Meqenëse çështja kombëtare e shqiptarëve në ish Jugosllavi ishte e pazgjidhur, dhe duke pasur parasysh se në formën legale ajo s`mund të avancohej më tepër sepse hegjemonizmi serb nuk e lejonte një gjë të tillë, atëherë e vetmja formë e veprimit ishte organizimi i fshehtë politik.

Kështu veproi NDSH-ja (Nacional Demokratët Shqiptarë) nga viti 1945 e këndej sepse nuk u pajtuan me aneksimin e ri të viseve shqiptare në Jugosllavi. Kjo Lëvizje e madhe, në gjirin e sajë kishte atdhetarë të spikatur si Gjon Sereqin, Azem Maranën dhe qinda e qindra të tjerë, të cilët jo vetëm që u dënuan me dënime drakonike burgu, por shum sosh edhe morën dënime me pushkatim. Pas shkatërrimit të kësaj Lëvizje nacional demokratike shqiptare, duke mos hequr dorë nga çlirimi i viseve të pushtuara u formuan edhe organizata të tjera të fshehta politike.

Për këtë qëllimi, viteve të 60-ta, 70-ta e 80-ta të shekullit XX u formuan organizata të ndryshme ilegale politike që për qëllim kishin zgjidhjen politike të shqiptarëve që mbetën në ish Jugosllavi, por si pasojë bëhej edhe zbulimi dhe arrestimi i tyre duke mbajtur burgje të rënda. Në ballë të kësaj lufte printe organizata ilegale politike e Adem Demaçit, Kadri Osmanit, Metush Krasniqit, Hydajet Hysenit, Abdullah Prapashticës dhe organizata të tjera me emra të ndryshëm, por me qëllime të njejta.

Meqenëse sigurimi sekret jugosllav (UDB-a) ishte i fuqishëm dhe bënte zbulimin e këtyre organizatave, u paraqit nevoja që të hartohet një material i fsheht për t`i udhëzuar veprimtarët se si të veprojnë në rrethana ilegaliteti dhe t`i shpëtojnë syrit zbulues të UDB-së. Ky material i fsheht u titullua **Armiku na ka në dorë vetëm aq sa e lejojmë ne vet**, apo ndryshe njihej si **Tezat e konspiracionit**.

Ky material ilegal, po nga rrugët e fshehta i ra në dorë edhe grupit tonë të ilegal politik në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit i cili përbëhej nga Bajram Dernjani, Shaban Çupi, Naser Dernjani e Sejdi Dernjani e që ishin të lidhur në bashkëveprim edhe me shokët e Kaçanikut si Remzi Elezi, Gafurr Luma, Remzi Krraba, Kadri Raka, Emrush Tafili, Mefail Vishi, Ismail Malsiu e Muhamet Qorri, ishte grupi i parë i organizuar në këtë trevë i cili nga viti 1981 e këtej vepronte për formimin e Republikës së Kosovës. Edhe ky grup, përkundër veprimit të fshehtë zbulohet në nëntorin e vitit 1985 dhe si pasojë mbajtën vite të gjata burgu. Grupi tjetër po i organizuar që vepronte fshehurazi në trevën e Hanit të Elezit ishte ai i Ibrahim Currit, Mehmet Ballazhit dhe Nexhat Ballazhit të cilët ishin në bashkëveprim edhe me shokët e Kaçanikut si Agim Dauti, Heset Malsiu e Hisret Kyçyku e të cilët u zbuluan në shtatorin e vitit 1987 dhe për pasojë u dënuan edhe ata me burgje. Që të dy grupet, gjatë veprimtarisë së tyre, arritën që të depërtojnë te shum njerzë të tjerë që gjatë arrestimeve mbetën të pazbuluar dhe e përbashkëta e këtyre dy grupeve ishte platforma e njejtë politike edhe pse nuk dinin për njëri tjetrin. E përbashkëta tjetër e këtyre dy grupeve ishte se të njejtit, pas demonstratave të vitit 1981 lexuan këtë material ilegal të cilin po e publikojmë në faqet e më poshtme.

Gjithnjë në kontekst kohor e historik, bëhet fjalë për një periudhë të largët, pra nga 2026 në 1981 kemi një distancë 45 vjeçare dhe tanimë shumë gjëra kanë ndryshur, madje jo vetëm sistemi shoqëror, por edhe Kosova është bërë shtet, por publikimi i këtij materiali (ne kishim edhe material të tjera të fshehta) tregon rrugën e gjatë të lirisë e cila ishte me sakrifica të shumta.

Në atë kohë, që të veproje ilegalisht jo vetëm që të priste arrestimi dhe burgu, por edhe izoloheshe nga shoqëria si armik i popullit, përjetësisht të ndalohej puna dhe familja leqitej nga rrethi shoqëror. Sa për ilustrim ua sjellim këtë dokument:



Shaban Qupi është i papërshtatshëm jo vetëm për LK por edhe për
proqesin edukativo arsimor.Ti ndalohet rreptësisht në kthimin e ushtrimit
të profesionit që bënë edukimin dhe arsimimin e breznive të reja.
Personat e tillë janë të papranueshëm për tërë shoqërin e gjërë
socialiste dhe për LK të Jugosllavisë ?

Materialin që po e trajtojmë e që siç shkruam më lartë ishte i fsheht, jo vetëm që lexohej, por në raste arrestimi duhej që t`i përmbaheshe sepse ishte një ndihmesë jo e vogël në rrethanat hetimore.

Në vazhdim, sjellim disa situata gjatë hetimeve dhe si tentonim të përdornim Tezat e konspiracionit.

Pas arrestimit më futën në stacionin policorë të Hanit të Elezit. Ky stacion policie nuk është më, por vendi i tij ishte aty ku sot është Xhamia e Çarshisë dhe më mbajtën mbi dy orë pa folur asnjë fjalë askush me mua (Nga Tezat e konspiracionit dija se kjo formë e veprimit ishte presion i thellë psikologjik)

Ky ishte stacioni i milicisë siç quhej atëherë në Han të Elezit, tani në këtë vend është Xhamia e Çarshisë

Në një situatë tjetër, derisa po udhëtonim në makinën e UDB-së ku më shoqëronin tre udbashë, më thanë:

- Njeh ti Adem Demaçin?
- Ademin nuk e njoh, por kam dëgjuar për ate.
- Ai është një burr i madhë dhe trim, kur e arrestonim, ai si burrat pranonte veprën, s`kishim se pse ta përdornim dhunën. (nga Tezat e dija se ky është një mashtrim që të pranoj veprën)
- Ti ishe arsimtar dhe ishe i martuar dhe me një gjendje jo të mirë sociale, prano veprën dhe ne të japim fjalën se të kthejmë në shtëpi, nesër shkon në punë dhe askush nuk guxon të pyes se si e pse. (Nga Tezat e dija se ky është një kurth i UDB-së)

Një situatë tjetër:

Derisa po udhëtonim natën dhe s`dija ende për në cilin burg, aty afër Gërlicës më thanë, po të qojmë tek shoku yt në Gjilan.

- Është i martuar shoku yt?
- Ai nuk është shoku im, por bashkëfshatar i imi.
- Është i martuar?- më pyetën ata.
- Jo, u thashë.
- S`do të ketë nevojë më të martohet, e kemi tredhur.(Nga Tezat e dija se ky është një presion i fortë psikologjik, por që mund të ishte edhe i vërtetë sepse gjatë historisë shumë i burgosuri ka mbetur i kastruar nga UDB-a)

Gjithnjë në kontekst kohorë, sjellim edhe disa situata të tjera. Kur u arrestova më 4 dhjetor 1985, krahas shumë pikave të tjera, ndaj meje u zbatua edhe hetimi nëpërmjet ,,detektorit të rrenave''.

Detektori i rrenave është një instrument elektronik, një mjet hetues që të matë emocionet, si: shpejtësinë e gjakut, skuqjen, zbehjen, dridhjen e zërit dhe emocione të tjera, dhe në atë kohë ishin të paktë, andaj ndaj meje u zbatua detektori fizik i quajtur ,,bashkimi i gjunjëve''

Pas torturave fizike me pendrek, kabëll, furje, goditje me shqelma e çka jo tjetër, ndaj meje u kërkua që ulur dhe i mbështetur për karrike, t`i bashkoj gjunjët e mi me gjunjët e hetuesit, në këtë rast udbashit dhe ta shikoja ate drejtë në sy, saktësisht drejt në sy. Pasi stabilizohej qëndrimi, udbashi fillonte me pyetje fillimisht të lehta dhe nga jeta familjare, si: sa antarë je në familje, sa motra, sa vëllezër, shkollën që e ke kryer e të ngjajshme, por në momentin e caktuar të shtronte pyetje kryqëzore të shpejtë dhe të përmendte emrin e ndonjë personi që ata dyshonin se është lidhja ime e pazbuluar. Poqëse skuqeshe, ose zbehesh ose të ngatërrohet zëri, pra nëse ke ndonjë ndryshim krejtësisht të vogël emocional, atëherë fillonin torturat fizike për zbulimin e anëtarëve të tjerë të organizatës.

Ky material i lexuar para arrestimit, sakt më ndihmoi sepse që në momentin që më thanë t`i bashkoj gjunjët e kam ditur se po zbatohet detektori i rrenave. Që në momentin e parë kam rregulluar frymëmarrjen dhe kjo ishte shumë e rëndësishme.(Zbatim i Tezave… në hetuesi UDB-a mund të përdorë grafologët dhe detektorin e rrenave)

Në rastin tjetër, gjatë bastisjes së shtëpisë, hetuesit s`kanë mundur të gjejnë asnjë material inkriminues sepse ato i kishim të fshehura në bazën tonë, në enë plastike dhe të futura në tokë largë shtëpisë.(Zbatim i Tezave… celula revolucionare, materialet ilegale të mos i mban në shtëpi)

Në anën tjetër në kuptim ideologjik, Jugosllavia 22 milionëshe ishte një shtet socialist dhe themeluesit e socializmit ishin Karl Marksi, Friderih Engelsi dhe Vlladimir Iliq Lenini dhe krahas fotografisë së Titos në zyre e parada maji, vendoseshin edhe fotografitë e themeluesve të socializmit dhe nëpërmjet filozofisë së tyre politike marksiste-leniniste ne kërkonim të drejtat tona, pra luftonim me armën e armikut, sepse në teorinë marksiste-leniniste njihej e drejta e kombeve për vetëvendosje deri në shkëputje dhe ne e kemi shfrytëzuar ate si armë lufte. Më poshtë po e shkoqisim një pjesë nga hetimet:

- Ne kemi të drejtë në vetëvendosjen tonë kombëtare sepse themeluesit e socializmit na e lejojnë një gjë të tillë.
- Ç`ke lexuar nga këto themelues që po i përmendë?
- Kam lexuar Kapitalin, Të drejtën e kombeve për vetëvendosje deri në shkëputje, Kam lexuar Dështimin e internacionales së dytë, kam lexuar librin Nga të fillojmë, Ç`të bëjmë, Dy tezat e socialdemokracisë në revolucion, kam lexuar librin Konspekt mbi kapitalin, kam lexuar Shteti dhe revolucioni, kam lexuar Komuna e Parisit, kam lexuar , Paraja, vlera e mbivlera dhe shumë e shumë të tjera.
- Edhe një murgeshë kishte lexuar Kapitalin e Marksit, jo që e donte, por dëshironte t`ia gjente mangësitë dhe ta sulmonte Kapitalin, të tillë jeni ju, tha hetuesi dhe kaloi në pyetje të tjera.(Zbatim i Tezave…çdo veprimtarë duhet ta mbrojë idenë për të cilën lufton)

Ky është objekti ku UDB-a zhvillonte hetimet në Gjilan. Në këto dhoma hetuese buka bëhej miell. Dhoma brenda rrethit është dhoma ku u zhvilluan hetimet ndaj meje.

Kur më dërguan në dhomën e burgut me të cilën ballafaqohesha për herë të parë, aty gjeta edhe të burgosur të tjerë dhe në fytyrë ishin të gjithë të zbehtë. Nga Tezat e konspiracionit e dija se brenda dhomës mund të ketë të

burgosur spiun të UDB-së, andaj edhe pse kishte pasur të burgosur politikë, duhej vëmendje e madhe. Në fakt unë frikësohesha prej tyre e ata frikësoheshin prej meje.

Që në ditën e parë, filluan hetimet por tani nga shokët e dhomës:

- Nga je, çka ke të kryer, pse je në burg e të ngjajshme dhe në fazën tjetër më pyetën se a shpërndahen pamflete në Kosovë?
- U thash se nuk di se ç`janë pamfletet, jetoj në një fshat të thellë, shtypin nuk e përcjell sepse ekonomikisht kam gjendje të varfër.
- Po pse të kanë arrestuar?
- Edhe unë po e pyes veten, pse?
- A kanë arrestuar dikend në fshatin tuaj?
- Po u thash, kanë arrestuar një bashkëfshatar timin. Është jurist para diplomimit. Po thonë se e kanë arrestuar për politikë, por unë se besoj një gjë të tillë.

Nga të burgosurit e politikës, hetimet vazhdonin me intenzitet dhe në vazhdim të tyre më pyetën:

- Siç po deklaron, ti qenke arsimtar. Cilat libra ose cilat romane të pëlqejnë më së shumti?
- U thashë se më pëlqejnë romanet e Sinan Hasanit. Ata qeshën me zë, mezi e frenova gazin edhe unë.

Me kalimin e ditëve dhe javëve kuptova se fatlumnisht kishin qenë shokë të mirë, shokë i kam edhe sot. Por kujdesi duhej të ishte i madhë. UDB-a fuste spiunët e tyre edhe brenda dhomave, këto na i mësonin Tezat.

Kjo ishte dhoma dhe krevati im në burgun e Gjilanit. Ishte në katin e parë dhe numri i derës ishte 15. Fotografia është bërë pasiqë ky burg u shpall muze në vitin 2017. Në këtë dhomë, pasiqë unë transferohem për burgun e Prishtinës, ka qëndruar edhe Ibrahim Curri nga Hani i Elezit, arrestuar në shtator të vitit 1987

Pas dy muaj hetime e të cilat zhvilloheshin natën në burgun e Gjilanit, në një moment të caktuar hetimor, në mes meje dhe tre udbashëve fatëkeqësisht shqiptarë e zhvilluam këtë dialog:

- A e shihni more se burgjet i keni mbushur plotë me të burgosur shqiptarë. Zgjohuni more që nga Fadil Hoxha (atëherë udhëheqës i krahinës së Kosovës), Lidhja Komuniste, Lidhja Socialiste (organe udhëheqëse të krahinës) dhe ju inspektor të UDB-së dhe publikisht të përkrahni Kosovën që të bëhet Republikë!
- Si ?! Edhe ne ?!
- Po. Kosova fiton statusin e Republikës dhe bëhemi të barabartë me të tjerët në Federatën Jugosllavë, ju si inspektor krahinorë, ngriteni në inspektor republikan dhe fitojmë të gjithë.
- Nga kjo që po thua ti, demek ju do të na lejoni të punojmë si inspektor në republikë?!
- Po u thash, ky është zanati juaj, i imi është në arsim.

- Jo vetëm që nuk bëhet kurrë Republika, por nëse eventualisht bëhet, ju jo vetëm që s`keni për të na lënë të punojmë, por do të na vrisni, andaj sa na e q… nanën ju, po ua q… nanën ne.(Zbatim i Tezave… kudo që të jesh, madje edhe brenda sistemit titist, shkatërroje dhe gërryeje ate përmbrenda)

Një situatë tjetër kemi edhe burgosjen e Mehmet Ballazhit po nga treva e Hanit të Elezit në shtatorin e vitit 1987 dhe në atë kohë ai kishte 20 vite dhe ishte në moshën krejtësisht rinore, por krahas torturave në dhomat hetuese të UDB-së, ate e mbajnë të vetmuar në qeli burgu mbi katër muaj e gjysmë pa pasur kontakte me asnjë njeri.

Kjo është qelia e burgut në Gjilan ku Mehmet Ballazhi ka qëndruar i vetmuar pa pasur asnjë kontakt me të burgosurit e tjerë. Në këtë qeli ka qëndruar rreth katër muaj e gjysmë nga shtatori i vitit 1987

Kujtojmë rastin tjetër të Bajram Dernjanit në burgun e Zrenjaninit në Serbi ku ka qëndruar me të burgosurit më kriminel serb dhe rreziku i mbytjes natën në gjumë ishte më se evident.

Të njëjtën rrugë dhe të njejtat sakrifica kishin edhe shokët e tjerë të burgosur, si Nexhat Ballazhi, Ibrahim Curri e Ferat Curri, duke mos e harruar edhe të pathyeshmin, veprimtarin model për atdhe, tanimë heroin Gafurr Loku i cili nga 8 vite e 6 muaj burg që mbajti në kazamatin e Idrizovës në Shkup është një kapitull i veçantë.

Me anë të këtyre rrëfimeve, sodo të shkëputura e fragmentare dhe me dromca të vogëla, lexuesi e studijuesi shqiptarë mund të kuptoj se sa e rëndë dhe sa e gjatë ishte rruga e lirisë. Lexuesi i sotshëm duhet ta kuptoj se në sistemin monist jugosllavë, fjala e lirë, shprehja e mendimit dhe veprimi publik ishin të ndaluara me ligj. E kur ishte fjala për shqiptarin, atëherë ligje të tilla kishte mjaftë. Krahas kësaj, ndaj një të burgosuri politik është përdorë dhunë e madhe fizike, dhunë e cila përfundonte me alivanosjen e të të burgosurit dhe vetëm kovat me ujë bënin rikthimin e tyre në jetë.

Nëpërmjet kësaj rruge, nëpërmjet këtyre torturave, nëpërmjet këtyre tmerreve po përgatitej luftëtari i ri i lirisë ku qëndrestari i burgjeve Kadri Osmani që ka mbajtur mbi 16 vite burg, tanimë i ndjerë, në një poezi të tijën të shkruar po në burgjet serbo-jugosllave thotë:

Kur i kapë revolta
T`i  s`ua varë strajcën
Kur të fusin në burg
Ti e çelë parajsën!

Kur kujtojnë se t`mbyllën
Fluturon në lartësi
Kur t`i ndalin librat
Krijon letërsi!

Kur të lanë t`uritur
Të ushqen ideali
Kur të lanë të ngrirë
N`ballë të çelë behari!

Kur të lanë n`beton
Ti e gjen livadhin
Kur të lanë në vetmi
Ti je bashkë me Bardhin.

Kur të qojnë në qoshe
Ti iu del në pritë
Kur të fusin në terr
Në ty lind një dritë!

Kur të bëjnë të padrejta
Ti një grevë e shpallë
Kur thonë se mbarove
Datën ua kallë!

Kur mendojnë se të fikën
N`krah e mban një botë
E kur t`i vejnë prangat
Shtatë herë je më i fortë!

Kur t`i shtojnë torturat
Shkrihesh në hare
Kur ta rjepin lëkurën
T`del një ma e re!

Kur të quajnë të pafe
Ti i ke tri feja
Kur ta presin kokën
Të dalin shtatë të reja!

Napërmjet kësaj poezie shprehet qëndresa e të burgosurve politikë shqiptarë nëpër burgjet jugosllave e që ishin shumë, si në Nish, CZ, Mitrovicë e Sremit, Lepogllavë, Goli Otok, Dob, Straragardishkë, Foqë, Zenicë, Shpuz, Pozharevc, Leskovc, Zrenjanin, Sombor, Idrizovë etj. Mjafton të lexojmë librin dokumentues **Qëndresa** të tanimë heroit të Kosovës Rexhep Mala dhe përballja e tij me udbashë si dhe librin **Në kthetrat e UDB-së** të heroit tjetër të Kosovës Gafurr Lokut që të kuptojmë sa e madhe ishte dhuna ndaj të burgosurve politikë. Por, kjo ishte rruga. Nuk kishte rrugë të tjera. Po ndërtohej luftëtari i lirisë të cilin patëm fatin edhe ta përjetojmë në luftën çlirimtare të Kosovës gjatë vitit 1998/1999, kur pjestari i UÇK-së me një automatik në dorë para u dilte tankseve serbe, dhe kjo ishte dhe mbeti përfundimisht madhështia e kohës dhe motivim për çdo gjeneratë që do të vie edhe pas nesh.
Mbi këtë bazë, dhe mbi këto krajata po e botojmë edhe këtë material i cili është njëri nga dokumentet e Lëvizjes, por që e kanë lexuar shumë veprimtarë, andaj si i tillë ka edhe vlerën historike.

Me vëllezërit Fazli e Selajdin Avdullahu nga Shurdhani i Gjilanit, me të cilët kam qëndruar në burgun e Gjilanit. Fazliu kishte qenë i burgosur edhe

në vitin 1975 dhe burgun e kishte mbajtur në Vranjë dhe kishte qenë bashkëveprimtar me Rexhap Malën dhe së bashku kemi qëndruar vetëm dy netë, ndërsa me Selajdinin mbi tre muaj ditë. Fotografi e vitit 2017.

Ky ishte koridori i burgut në Gjilan, fotografi e vitit 2017

ARMIKU NA KA NË DORË VETËM AQ SA E LEJOJMË NE VETË

Disa udhëzime të përgjithshme për punën praktike revolucionare dhe për qëndrimin që duhet të mbajmë para policisë.

Eshtë koha e fundit që edhe në lëvizjen revolucionare të Kosovës të bëhet një kthesë rrënjësore. Kur themi kështu, mendjen e kemi në radhë të parë te lëvizja e organizuar, por pa e përjashtuar edhe lëvizjen spontane, të pavarur, gjysmëlegale, legale etj. Deri më sot, te ne, çdo organizim apo tentim që të organizohen masat në luftë për liri politike, nacionale e shoqërore, në një mënyrë ose në një tjetër, është zbuluar dhe shuar me gjak dhe për pasojë aktiviteti revolucionar ka pushuar për një kohë të gjatë. Për të qenë edhe më e madhe fatkeqësia, për aktivitetin e grupeve revolucionare në Kosovë - masat e gjera popullore kanë mësuar vetëm pas burgosjes apo gjykimit të këtyre grupeve dhe organizatave. (Përjashtim bën vetëm grupi organizues i Demonstratave të vitit 1968).

Ç'e kushtëzoi zbulimin e këtyre grupeve e të këtyre organizatave revolucionare?

Shkaqet janë të shumta dhe duan kohë të gjatë studimi. Por, ne do të përpiqemi t'i prekim këtu ato shkaqe që na duken nga kryesoret.

Një nga arsyet kryesore për zbulimin e tyre ka qenë botëkuptimi i organizatorëve, të cilët çështjen e luftës dhe të fitores e kanë parë si një fenomen të shkurtër e spontan dhe si një proces të gjatë, që mund të vazhdojë me dekada, që ka hopet e zigzaget e veta, që është një kompleks i gjerë e i thellë, i cili u përgjigjet parimeve leniniste që duhen peshuar shumë dhe nga të gjitha pikpamjet. "Revolucioni është vepër e masave, e jo e një grupi njerëzish, sado revolucionarë dhe të guximshëm që të jenë ata". Vetëm duke organizuar, duke mobilizuar dhe duke armatosur masat me armën e fuqishme ideologjike të marksizëm-leninizmit, mund të arrihet fitorja e revolucionit. Çdo iluzion për ndonjë rrugë tjetër të fitores, është i kotë.

Përveç kësaj, shokët "e vjetër" nuk i kanë kushtuar sa duhet kujdes ngritjes ideopolitike dhe krijimit të kuadrove të forta, që do të vepronin drejt dhe energjikisht në çdo situatë, duke iu kundërvënë armikut në të gjitha rrethanat, pa marrë parasysh sa janë ato të ndërlikuara.

Së treti, organizatorët e mëparshëm (për të cilët ne, natyrisht ushqejmë respekt të madh) kanë bërë një gabim të madh taktik, e kanë preferuar sasinë e jo cilinë, ndonëse kjo e dyta është kurdoherë primare. Për pasojë, në radhët e grupeve dhe të organizatave kanë depërtuar elemente armiqësore, që e kanë kushtëzuar dhe e kanë shpejtuar zbulimin, qysh në hapat e parë të veprimtarisë.

E katërta është konspiracioni i dobët që përvidhej nëpër radhët e grupeve revolucionare. Me mospërfilljen dhe moszotërimin e teknikës së konspiracionit, është shkelur një nga parimet themelore të punës politike në kushtet e legalitetit. Lenini, udhëheqësi i madh i proletariatit, theksonte: "Një parim, kryesori sa i përket

organizimit, të cilit duhet t'i përmbahen të gjithë udhëheqësit dhe kuadrot e partisë së klasës punëtore, duhet të jetë konspiracioni më i thellë, i cili sigurohet në bazë të përvojës, mendimit dhe në bazë të përpjekjeve". Në këtë pikëpamje kanë çaluar shokët "e vjetër". Pas kësaj, nuk duhet harruar as qëndrimi i lig dhe qyqar i disave, në gjyq dhe gjatë hetimeve.

Duke u nisur nga ato që përmendëm më sipër, në radhë të parë nga parimi leninist që "nga pësimet të nxjerrim mësime", është koha e fundit të bëjmë një kthesë rrënjësore në punën tonën revolucionare, të trasojmë brenda radhëve tona një traditë të organizimit të hekurt, të konspiracionit të thellë dhe të veprimtarisë së gjallë revolucionare, që t'u përgjigjen detyrave dhe kërkesave të kohës.

Prandaj, pikërisht pse ndodhemi në prag të një lufte të gjatë e të vështirë, duhet të marrim qëndrim të prerë për t'ju përmbajtur me përpikmërinë më të madhe udhëzimeve të poshtëshënuara, duke i zhvilluar dhe duke i përsosur veprimet tona në mënyrë krijuese e revolucionare.

Udhëzime për konspiracion

Teknika e ruajtjes së fshehtësisë së punës revolucionare - konspiracioni, arrihet me respektimin e përvojave ekzistuese të punës politike në kushte të legalitetit dhe me krijimin e përvojës personale. Çdo sulm i policisë mbi radhët tona dhe mbi veprimtarinë tonë ilegale, çdo përcellje, marrje në pyetje nga ana e policisë etj., na japin dorë t'i kontrollojmë të metat dhe t'i përforcojmë anët e vlefshme të teknikës sonë konspirative; t'i perfeksionojmë ato, duke i zhvilluar dhe duke i përsosur në përputhje me kushtet tona. Nëse shfrytëzohet rregullisht përvoja, pa përjashtim dhe me ndërgjegje të lartë, atëherë s'ka kurrfarë dyshimi se sulmet e reja të policisë do ta dëmtojnë gjithnjë e më pak veprimtarinë tonë dhe radhët tona, ato sulme do të na shërbejnë për ta përsosur në shkallë edhe më të lartë teknikën e konspiracionit.

Celula revolucionare duhet të jetë e aftë, që përkundër gjithë përpjekjeve të policisë dhe të agjentëve të saj, të ruajë forcën dhe vitalitetin e vet revolucionar. Për ta arritur këtë qëllim, ajo duhet të veprojë me përpikmëri të madhe në punën e vet ilegale, shpirti i së cilës është konspiracioni. Ajo mund t'ia arrijë qëllimit të vet nëse u përmbahet udhëzimeve vijuese, që janë rezultat i përvojës sonë dhe i përvojës së shumë partive revolucionare në botë.

Sjellja e anëtarëve të celulës në përgjithësi

1. Anëtari i celulës revolucionare ilegale nuk guxon të dallohet nga rrethi i vet - me veshmbathje as me qëndrim. Ai nuk duhet të mbajë ngjyra karakteristike "revolucionare", "patriotike", me emblema të ndryshme etj. Ai nuk duhet të flasë kudo për organizim a për revolucion.

2. Si anëtar i një celule, nuk duhet t'u tregosh shokëve për lidhjet e tua brenda celulës me të cilën ke filluar të punosh. Për veprimtarinë tënde politike nuk duhet të dijë as familja, madje as shoqja jote e jetës.

3. Shokët e celulës që janë nën kontrollin e policisë (që kanë rënë në sy dhe i përcjell policia), mos i përshëndet në rrugë e mos rri me ta në vende ku mund t'ju shohë ndokush, sepse mund të biesh edhe ti në sy të policisë.

4. Shokët e punës (ilegale) nuk duhet t'ia zbulosh askujt. Takimet e panatyrshme me ta, qoftë edhe kur janë fare të afërta, ndalohen rreptësisht.

5. Mos mbaj me vete letra e adresa të njerëzve "të kompromentuar" para policisë. Mos mbaj shënime, ditarë lidhur me punën revolucionare. Adresat e nevojshme duhet t'i mbash mend, ose t'i shënosh me simbole të caktuara, por në atë mënyrë që simbolet të mund t'i interpretosh e t'i arsyetosh me ndonjë llogari tënden private etj. Adresat e rrugët që kanë të bëjnë me persona të celulës duhet të mbahen mend mirë, që të mos pyeten për to në rast nevoje njerëzit e panjohur.

6. Për bartjen e materialit ilegal (libra, afishe etj.), shërbehu me persona neutralë, por në çdo rast duhet të jesh i gatshëm ta zhdukësh atë material, sepse ai nuk duhet të bjerë kurrsesi në dorë të policisë. Kur ke me vete ndonjë letër, pusullë etj., dhe të kërcënohet rreziku, atë duhet të jesh i gatshëm ta asgjësosh patjetër, qoftë edhe duke e gëlltitur.

7. Në banesë e në shtëpi mos mbaj materiale kompromentuese: dokumenta, literaturë ilegale etj. Gjithmonë ta kesh parasysh bastisjen dhe arrestimin. Prandaj, vendbanimi yt duhet të jetë në çdo kohë "i pastër", sepse dihet që policia nuk lë vend pa i futur hundët. Materialet ilegale fshihen jashtë shtëpisë, atje ku s'ka rrezik të zbulohen.

8. Nëse para policisë nuk je zbuluar ende si revolucionar, atëherë në banesë mos mbaj as literaturë e sende legale që kanë ndonjë karakter revolucionar. Kështu, mundësia për t'u kompromentuar para policisë e personave të dyshimtë, do të jetë minimale.

9. Gjatë kryerjes së aksionit a të detyrës së caktuar, ose pas kryerjes së tyre, e ke të ndaluar t'i tregosh kujt se ke bërë këtë apo atë. Për detyrën apo aksionin e kryer, duhet të dinë vetëm shokët e punës. Edhe më pak vend ka për lëvdata.

10. Gjatë kryerjes së aksionit, gjatë ikjes etj., të kesh kujdes të madh mos është duke përgjuar njeri. Sjellja jote duhet të jetë shumë e natyrshme, të mos bjerë në sy as të kalimtarit të rastit.

11. Kur gjatë bastisjes apo arrestimit të jenë zbuluar gjurmë të punëve revolucionare (për shkak të pakujdesisë së cilitdo anëtar të celulës, që nuk ka qenë

sa duhet konspirativ dhe e ka nënvlerësuar forcën e armikut), kjo gjë konsiderohet si një lloj tradhtie, dhe anëtari që ka vepruar kështu, kur të dalë nga duart e organeve shtetërore, do të merret në përgjegjësi për lëshimet e vete të çfarëdo natyre që të kenë qenë ato.

Mbajtja e takimeve

1. Për vendin e takimit duhet të dinë vetëm anëtarët e celulës. Vendi duhet të jetë i përshtatshëm dhe të mos ketë rënë në sy të policisë. Aty duhen vënë shenja të caktuara që shihen prej së largu dhe tregojnë a është i lirë vendi, apo ka dyshime. Shenjat e caktuara për vendin e takimit duhet të mbahen mirë në mend. Për çdo takim caktohen vendi, shenja dhe parulla e re.

2. Për arsyet objektive, që do të shihen në pikën e tretë, gjithmonë caktohet edhe vendi dhe termini rezerv i takimit.

3. Në takim shkohet absolutisht në kohën e caktuar - as më herët as më vonë. Nëse një shok nuk ka dalë me kohë, atëherë kalohet në takimin rezervë, sepse mund të merret me mend se mosdaljen e shokut në takimin e parë, e ka kushtëzuar ndonjë e papritur dhe, në këso rastesh, shokët e celulës vihen në gjendje gatishmërie. Prandaj, çdo vonesë e paarsyeshme, sado e vogël qoftë, dënohet rreptë në takimin vijues.

4. Për çdo takim duhet të bëhet arsyetimi i përshatshëm bindës para personave të jashtëm; ndeja duhet të maskohet, kinse pihet çaj e kafe, luhet shah, përgatiten provimet apo dëgjohet muzikë etj.

5. Në banesat konspirative shkohet vetëm kur është e domosdoshme.

6. Kur të shkosh në takim, shiko më mirë mos je i përcjellur prej ndonjë agjenti. Nëse ke hetuar gjë, ndërroje drejtimin. Shokët i njofton më vonë për arsyen. Kujdes të veçantë duhet të kenë sidomos shokët që janë në sy të policisë dhe ata që kanë qenë të burgosur. Këta të fundit, veçanërisht në kohën që sapo kanë dalë nga burgu, duhet të jenë më se të kujdesshëm.

7. Je nisur për në takim, ose kthehesh nga takimi. Gjithmonë duhet të jesh i gatshëm që pyetjeve të policisë, agjentëve apo provokatorëve t'u përgjigjesh pa ngurrim e belbëzime, kuptohet - duke ua fshehur natyrshëm të vërtetën lidhur me vendin ku je duke shkuar apo ku ke qenë dhe lidhur me arsyet që ke për të shkuar atje.

8. Takimet tona janë shumë të rëndësishme dhe për këtë arsye ato nuk duhet të zgjasin shumë dhe kështu të rrezikohen nga zbulimi. Ato duhet të jenë të thukta dhe me domethënie të thellë. Zgjatja e tyre e tepruar është e dëmshme, sepse ngjall dyshime.

9. Vendi i takimit duhet të ndërrohet sa më shpesh, se kështu zvogëlohet mundësia që t'i biem ndokujt në sy.

10. Celula duhet ta ketë bazën e vet të fshehtë, ku lihen mjetet dhe materialet ilegale.

11. Çdo anëtar i celulës duhet ta ketë bazën e strehimit (evakuimit), ku shkon kur rrezikohet nga policia. Për atë bazë duhet të dijë vetëm ai.

12. Organizata, e bashkë me të celulat, duhet të sigurojnë baza strehimi për anëtarët e rrezikuar, si dhe kanale të sigurta për kalimin e kufirit, kur rreziku të bëhet më i madh për ndonjë anëtar.

Shpërndarja e materialit, shtypit dhe literaturës ilegale.

1. Literatura dhe shtypi revolucionar, si dhe materialet e ndryshme propagandistike, shpërndahen dhe lexohen sipas planit të formuluar nga celula, të cilit duhet t'i përmbahemi rigorozisht. Literatura ilegale ka për ne rëndësi të jashtëzakonisht të madhe, prandaj duhet ta ruajmë që të mos bjerë në dorë të policisë, po edhe të kujdesemi që të mos qarkullojë kot - pa u lexuar dhe pa u përvetësuar nga anëtarët e celulës.

2. Literatura ilegale u jepet vetëm njerëzve të besueshëm. Duhet të kujdesemi vazhdimisht që në materiale të mos shënojmë emra, data e çkado tjetër madje as në mbështjellësen e tyre prej gazete, sepse ndryshe i japim mundësi armikut për të na identifikuar. Libri jepet vetëm në katër sy, pa dëshmitarë.

3. Punimet, referatet dhe shënimet që përgatiten në radhët e celulës, duhet të ruhen me kujdesin më të madh. Të nevojshmet ndalen, të panevojshmet digjen dhe hiri i tyre asgjësohet edhe ai me kujdes. Në shënime të mos përmenden emra e data të rëndësishme.

4. Afishet shumëzohen e shpërndahen, rigorozisht, me dorëza plastike Gjatë shpërndarjes është i domosdoshëm maskimi. Veçanërisht këpucët e mbathura në aksion, duhet të zhduken. Afishet shpërndahen absolutisht në kohën e caktuar Ato i shpërndajnë vetëm anëtarët e celulës, pa praninë e njerëzve të tjerë.

5. Ngjitja dhe shpërndarja e afisheve bëhet zakonisht natën vonë. Më ati rast, gjithmonë, duhet të bëjnë roje së paku dy shokë, që të evitohet befasia. Vend i ngjitjes caktohet me plan. Në aksion punohet shpejt e pa zhurmë. Terreni, tek shpërndahen traktet, duhet të njihet me hollësi.

6. Para aksionit, banesa e aksionistit pastrohet plotësisht nga literatura dhe materiali revolucionar. Kurse, aksionisti, duhet të ketë kujdes që të sigurojë patjetër para familjes dhe policisë një alibi të sigurtë, me të cilin arsyetohet sa më bindshëm mungesa e aksionistit gjatë kohës që ka qenë në aksion.

7. Kujdes të madh duhet të kemi, sidomos, kur blejmë material për shumëzimin e trakteve, afisheve etj. Shitoret ku blehet materiali i tillë janë në mbikqyrjen e policisë. Prandaj, nevojat duhet t'i plotësojmë duke u furnizuar m këtë materiali nëpër shitore qytetesh të largëta dhe gjithmonë duke gënjyer se j nëpunës a daktilograf i kësaj apo asaj ndërmarrjeje.

Demonstratat dhe tubimet legale

1. Demonstratat kanë sukses vetëm kur përgatiten mirë, për një kohë të gjatë, pra, pasi të jenë studiuar mirë kushtet dhe disponimi i masave.

2. Demonstratat i udhëheq këshilli i caktuar, i cili është i vetmi që ka të drejtë të japë direktiva, ta mbrojë qëllimin e tyre para organeve të pushtetit, bile edhe brohoritjeve të masës t'ua japë kuptimin e shëndoshë politik.

3. Gjatë demonstratave duhet të ruhet disiplina e hekurt dhe çdo udhëzim i udhëheqjes së demonstratës duhet të zbatohet me përpikmërinë më të madhe. Të mos mbahen veshmbathje e emblema simbolike, sepse burgosjet në raste të tilla janë masive. Pjesëmarrjen tënde në demonstratë do ta arsyetosh si kalim rasti, apo në ndonjë mënyrë tjetër, të cilën do të jesh në gjendje ta mbrosh sa më natyrshëm.

4. Anëtarët e celulës nuk duhet të rrinë grumbull gjatë demonstratës, por të shpërndahen në pika të caktuara dhe të vigjëlojnë me symprehtësinë më të madhe dhe kurdo të jenë të gatshëm të ndërmarrin masa konkrete për drejtimin e mbarë të demonstratës kur ajo të ketë marrë drejtim të gabuar.

5. Pas demonstratës, celula merr masa për evakuimin në vende të sigurta të shokëve që janë rrezikuar.

6. Në mbledhjet legale, kur anëtari i celulës është edhe anëtar i ndonjë forumi shtetëror, duhet të jetë shumë i kujdesshëm e të mos zbulohet para kolegëve të tij si revolucionar, qoftë me ndonjë gjest apo fjalë. Në atë vend pune, ai vepron për nevojat dhe në emër të celulës, jo për të mirën e armikut, por për ta brejtur atë përbrenda, për t'i studiuar makinacionet e tij antipopullore.

7. Kudo që të punojë (ndërmarrje, shkollë, uzinë, forum etj.), anëtari i celulës duhet të jetë gjithmonë vigjilent për kurthet eventuale. Me sjelljen e militantit të mirë, ai do të ngjallë admirim te njerëzit e ndershëm, kështu që për armikun do të bëhet e pamundshme të kthejë masën kundër tij. Prandaj sjelljet e anëtarit të celulës nuk duhet ta lëkundin me asnjë gjest autoritetin e fituar njëherë te masa, përkundrazi, ai duhet të bëhet shembull i njeriut të edukuar, të kulturuar e të flijueshëm, shembull i njeriut me moral dhe karakter të çeliktë.

8. Mbaje mend: çfarëdo pozite që të kesh zënë në aparatin shtetëror titist, duhet të mbash gjithmonë parasysh se ti atje vepron në emër të një çështjeje të madhe e të drejtë. Prandaj, s'ka vend për sjellje sipas rastit dhe dëshirës, e aq më pak për mendjemadhësi të kotë që je duke mbajtur një pozitë sado të lartë.

Agjentët provokatorë

1. Mos e harro mendimin politik se ai që nuk është me ty, është kundër teje. Prandaj shmangiu takimeve me njerëz të dyshimtë dhe të panjohur. Personat e tillë duhet të studiohen mirë, që të hetohet qëllimi i tyre. Për dyshimin më të vogël duhet

t'i njoftosh shokët, se me ndihmën e tyre do të marrësh informata më të sigurta se kush është, prej nga është ai dhe çfarë qëllimesh ka. Për çdo eventualitet, personi i panjohur a i dyshimtë duhet të jetë nën mbikqyrjen e përhershme të celulës. Mos harro parimin: Dyshoj për gjithçka!

2. Kujdesi i madh, si një nga kërkesat themelore në punën ilegale, mund të na bëjë të dyshojmë edhe për ndonjë anëtar të celulës: sesi është vënë në shërbim të policisë etj. Interesi i çështjes e do që ndaj tij të merren menjëherë masa, që të vërtetohet sa më parë a është me vend dyshimi apo nuk është. Por, dyshimin tonë, në asnjë mënyrë, nuk duhet t'ia shfaqim personit në të cilin kemi dyshuar. Lidhjet me të duhet t'i mbajmë edhe më tej, por vetëm ato më të domosdoshmet, që nuk e rrezikojnë çështjen tonë. Veprimi i kundërt - alarmimi para se të vërtetohet që është me vend dyshimi, është për dënimin më të rreptë, sepse fut konfuzion dhe i dezorienton radhët e celulës, e po kështu e humb edhe autoritetin tonë te masa.

3. Armiku bën çmos për të futur konfuzion në radhët tona, duke njollosur vetë njerëzit e celulës. Nëse edhe ne dyshojmë dhe përhapim fjalë pa e vërtetuar dyshimin tonë, atëherë e kemi ndihmuar armikun. Kjo gjë dënohet rreptësisht në lëvizjen revolucionare. Pos kësaj, alarmimi i celulës para se të vërtetohen dyshimet lidhur me anëtarin e celulës, jo vetëm që e pengon shumë zhvillimin normal të aktivitetit, por e bën të pamundur edhe zbulimin e armiqve dhe të provokatorëve të vërtetë, që u ka shkuar përdorësh të depërtojnë në radhët tona.

4. Depërtimi i agjentëve në radhët tona, nuk duhet të bëhet shkak për panik dhe për pezullimin e veprimtarisë sonë revolucionare. Përvoja ka treguar se një agjent të tillë mund ta zbulojmë vetëm në sajë të konspiracionit të thelluar dhe të organizimit të sforcuar. Prandaj, në këso rastesh, aktiviteti ynë jo vetëm që nuk duhet të bjerë, po përkundrazi duhet të bëhet edhe më intensiv.

5. Ndonjëherë, policia ka sukses ta bëjë për vete ndonjë nga njerëzit tanë të afërm. Këta kanë mundësi të zbulojnë shumëçka lidhur me ne. Në rrethin tënd, pra, duhet që shokët e celulës t'i prezantosh me emra e adresa të rrejshme, dizorientuese.

6. Gjithmonë duhet të jemi shumë të rezervuar nga njerëzit që haper menjëherë, duke folur për politikë etj. Ata duhet t'i çorientojmë në mënyrë të natyrshme, deri sa të mos e kemi marrë vesh qëllimin e tyre të vërtetë.

Bastisjet, burgosjet, hetimet

Lufta politike në kushte të ilegalitetit nuk është punë e thjeshtë as e lehtë po një rrugë plot kujdese, mundime, vuajtje e sakrifica. Që në fillim të punës son të organizuar në kuadër të celulës, ekziston mundësia të burgosemi, të torturohem etj. Me një fjalë, i ekpozohemi një rreziku të madh, se dihet që kemi të bëjmë me nj armik të rrezikshëm, i cili nuk ka lënë gjë pa bërë mbi popullin tonë. Prandaj, në çd kohë duhet të jemi krejtësisht të vetëdijshëm se para kujt gjendemi dhe çfar interesash mbrojmë. Edhe sjellja jonë para xhelatëve titistë, pra duhet të jetë sjellj

e denjë deri në pikën e fundit për luftën e rreptë kundër një armiku jashtëzakonisht të egër: duhet të kemi zgjuarësi e qëndrueshmëri thuajse mbinjerëzore. Torturave dhe cinizmit të armikut, duhet t'i përgjigjemi flakë për flakë me qëndrimin tonë të palëkundshëm heroik dhe me gjuhën e fuqishme të drejtësisë dhe të qëllimeve e idealeve tona të larta.

1. Gjatë bastisjes e arrestimit, ne duhet ta ruajmë qetësinë dhe gjakftohtësinë. Policia do të dyshojë më shumë, sa më shumë që të shqetësohemi ne para saj. Kur të ka hyrë në shtëpi policia, duhet të marrësh masa që në familje të mos shkaktohet panik. Qetësoji anëtarët e familjes, kurse fëmijët largoji menjëherë, te fqinjët e gjetkë.

2. Gjatë bastisjes, mos u nxeh kurrsesi. Mos fol gjë, se policisë do t'i japësh dorë të të rrahë ndërsy të familjes, apo të të fyejë rëndë etj. Bëju shumë gjakftohtë! pari shpirtërisht. Këtë qëllim të saj, kryesor, policia përpiqet ta realizojë me presione të ndryshme psikologjike: të le në pritje me orë të tëra pa të pyetur gjë fare, të fut në birucën ku s'di kur është ditë e kur është natë, të merr me të mirë, pastaj të fyen, më në fund fillon me torturat e rënda fizike dhe me metoda të tjera të shumta, që kanë një qëllim të vetëm: që ti të pranosh çkado. Gjakftohtësia, maturia dhe pjekuria e madhe, kjo është arma e vetme po shumë e fuqishme, të cilën e përdor revolucionari i vërtetë më këtë rast.

4. Para hetuesve nuk guxon të pranosh asgjë, as cikërrimin më të vogël. Çdo fjalë, gjest a vepër e pranuar, jo vetëm nuk ta lehtëson pozitën, por bëhet shkas që hetuesit të presin edhe më shumë prej teje dhe t'i intensifikojnë hetimet e torturat.

5. Nga qëndrimi yt varet sa do të rrish në burg! Prandaj: sa më pak fjalë!

6. Pos që përdorin metoda të rrahjes e të mundimeve, hetuesit policorë ndërrojnë vazhdimisht taktikë. Të flasin ëmbël, të bëjnë vend të ulesh, të ofrojnë cigare, ushqime, të flasin gjoja me një intimitet krejtësisht njerëzor e privat për ardhmërinë, perspektivën tënde e të familjes etj. Fill pas hutimit tënd sado të vogël nga "mirësjellja" e tyre, ata shfrytëzojnë rastin për pyetje të papritura. Ruaju se bie në kurth. Përgjigju shkurt, seriozisht dhe vetëm për ato që të përkasin ty. Dhe gjithmonë ta kesh parasysh se ndodhesh jo para qengjit, po para armikut më të madh që ka pasur ndonjëherë populli ynë.

7. Një metodë tjetër çnjerëzore e UDB-së është ajo e përdorimit të grafologëve, imituesve të zërit dhe "detektorit të rrenave". Grafologu kopjon shkrimin e shokut tënd dhe policia përpiqet të të mashtrojë t_ , gjoja shoku yt ka dhënë deklaratë me shkrim; ose e kopjojnë në shirit megnetofoni zërin tënd, të imituar mirë nga ekspertët e policisë, e të thonë se ti e ke kot që hesht, pasi shoku yt, ja, ka pranuar me gojë të vet; ose të marrin në pyetje në praninë e "detektorit" të rrenave, i cili për çkado që flet ti, të thotë se je duke gënjyer. Por, s'duhet t'u biesh në kurthet e rrezikshme e të paskrupulla, se ata s'dinë gjë për ty.

8. Në pyetje të marrin zakonisht në kohën më kritike, kur je i përgjumur. Duhet ta marrësh veten në dorë, të këndellesh dhe të marrësh qëndrim përkatës ndaj spekullimeve të tyre.

9. Sidomos ditët e para të arrestimit duhet të kesh kujdes të madh sa i përket gjellës: cigaret e tyre, bukën, pijet e ndryshme - mos gabo t'i marrësh! Për çdo eventualitet, nëse heton diçka, po gjithmonë përsëritja vetes: Unë nuk di gjë!

10. Duke parë se je i pamposhtur ndaj torturave, policia përpiqet të bëjë presion mbi ty edhe nëpërmjet familjes sate. Kurrë mos e harro një fakt: ata nuk dinë asgjë për ty dhe kurrë nuk mund të jenë të sigurt për asgjë, pos për ato, që pranon ti vetë. Ata vetëm dyshojnë, përpiqen të gjejnë një fije fakti, që pastaj të nxjerrin edhe gjëra të tjera. Mos harro, pra, se ata nuk dinë asgjë, asgjë fare!

11. Nëse të kanë torturuar, menjëherë kërkoje mjekun!

12. Kurrë mos jep kurrfarë deklarate me shkrim! Justifikohu se çka ke pasur të thuash, e ke thënë me gojë, e nëse ata duan të shkruajnë, le të shkruajnë vetë.

13. Gjatë mbajtjes së procesberbalit para gjyqtarit hetues, të kesh kujdes të madh, se edhe ai është polic! Prandaj, kur ta nënshkruash protokollin, nënshkrimi yt le të puqet plotësisht më rreshtin e fundit të protokollit, që ata të mos mund të shtojnë asnjë fjalë pos atyre që ke nënshkruar.

14. Nëse të ballafaqojnë me ndonjë shok, me të cilin s'ke pasur si të merresh vesh më parë, shikoje drejt në sy dhe thuaj, pa ngurim, se nuk e njeh fare. Natyrisht, mos gënje për qiell, nëse atë shok e ke të afër nëse ke mësuar apo ke punuar në një vend me të.

15. Nëse të del përpara ndonjë "shok", që e ka tradhtuar çështjen, dhe t'i numëron faktet, as atëherë mos prano asgjë. Çdo gjë që e rrezikon çështjen, duhet mohuar në mënyrë kategorike.

16. Deklarata jote e parë, duhet të jetë gjithmonë e njëjtë me ato të pastajmet. Në këtë drejtim të mbahen mend mirë hollësitë dhe për çdo pyetje të hetuesve përgjigja të jetë e gatshme, kategorike dhe e bindshme.

17. Nëse gjatë bastisjes të kanë gjetur edhe ndonjë material kompromet ues, duhet të jesh aq më vigjilent. Arsyetohu në mënyrë të natyrshme: sesi atë material e ke gjetur, ta kanë hedhur, ta kanë dërguar me postë etj. Ndërkaq, po qe se nuk kanë gjetur asgjë atëherë, me përgjigjet e tua, jepu të kuptojnë jo vetëm se je i pafajshëm, po edhe naiv e i urtë.

18. Për ndonjë libër që ta kanë gjetur, s'bën të deklarosh se e ke prej këtij apo atij shoku: sado i pafajshëm të jetë shoku yt me denoncimin tënd "të vogël" do t'i nxjerrësh shumë telashe.

19. Edhe pas pyetjeve më të thjeshta të policisë duhet të shohësh kurthet më të rrezikshme me prapaskena të tmerrshme.

Policia sekrete dhe përgjithësisht shteti policor jugosllav, si në planin teorik ashtu edhe në praktikë, ka investuar përpjekje të ethshme dhe mjete të mëdha materiale për ta zgjeruar rrjetin e bashkëpunëtorëve dhe për t'i prefeksionuar vazhdimisht metodat e fëlliqura fashiste për shuarjen e revolucionit dhe për torturimin e forcave revolucionare në çfarëdo shkalle të veprimit të tyre. Dhe, në këtë drejtim, ajo ka shkuar përpara aq sa t'ia kenë zili edhe sistemet më të egra antipopullore fashiste. Ky fakt te një pjesë e njerëzve tanë, ka krijuar përshtypjen e gabueshme dhe të rrezikshme se si UDB-ja ditka gjithçka, madje, edhe sa lugë keni

në shtëpi. Përvoja e revolucionarëve dhe patriotëve tanë, të rysur me dekada në luftë të pakompromis me policimë jugosllave, ka nxjerrë konkluzione të kundërta. Policia jugoslla.e, sikundër i gjithë sistemi revizionist e social-shovinist i këtij vendi, është në kalbëzim. Sidomos kur ka të bëjë me luftën tonë, ky sistem tregon pika të qarta dobësie, që e kanë rrënjën te padrejtësia, qëndrimet e tyre përballë drejtësisë dhe shenjtërisë së luftës sonë. Ky fakt policinë jugosllave e bën edhe një herë më të ligë sesa është ajo në të vërtetë.

Përveç kësaj, megjithë rrjetin e zgjeruar të spiunazhit, megjithë kuadrin e rekrutuar nga radhët e popullsisë shqiptare, policia nuk ka pasur sukses, siç do të dëshironte të depërtojë në masë të rrezikshme në ambientin shoqëror e familjar të shqiptarëve, se populli, duke mos e njohur si mbrojtëse të interesave të tij, po përkundrazi pikërisht si armikun më të madh të këtyre interesave nuk ia ka hapur UDB-së shtigjet, nga do të depërtonte ajo në gji të këtij populli.

Prandaj, në ballafaqimin tonë me këtë polici, aq sa është i gabueshëm nënvleftësimi i forcave të saj, është gjithashtu i gabueshëm edhe mbivlerësimi i atyre forcave.

Prandaj, motoja kryesore, që duhet të na prijë në të gjitha ndeshjet me policinë, duhet të jetë se: Policia fashiste jugosllave di për punën tonë vetëm aq sa do të tregohemi ne të gatshëm, me dobësinë tonë, t'i tregojmë vetë...

(Ky punim është shpërndarë në radhët e organizuara në Kosovë më 1973).

Në vazhdim, krahas Tezave, po e botojmë edhe një material tjetër që është përdorur ilegalisht nga anëtarët e Lëvizjes. Ky material ka qarkulluar fshehurazi edhe mes nesh dhe dy strofat e para i kam mbajtur mend që nga viti 1981 e këndej. Poemën në tërësi e riprodhova nga libri ,,Pranverë në katër pamje'' të Hydajet Hysenit, botuar në vitin 2006

Qan Kosova për zogjtë e saj

Mbi Kosovën time,
Nata ka pllakosur;
Bie shi pa pra
Acari s`ka të sosur.

Iknin që këtej,
Lejlek e bilbila;
Mbushej toka ime
Bisha, egërsira.

Bashkë me zogjtë Kosovë,
T`ikin bij e bija;
Në kurbet Kosovë,
Ç`tu tret moj rinia!

Bijtë e tu në kurbet
Bijtë e tu në shtegtime;
Lëndinë e madhe lotësh,
Gjithë Kosova ime!

Trena të zi si nata,
Vijnë bosh e shkojnë plot;
Ndarje vetëm ndarje,
Shi i tërë me lot!

Nëna, nuse, fëmijë,
Lotët derdhnin gurrë;
Zemra e kurbetçiut,
Digjet sikur furrë!

Treni i zi si futa,
Rrëshqet drejt veriut;
Zemra e përvëluar,
I ndahet kurbetçiut!

Mos shpejto kaq fort,
Mor ti tren i zi,
Ndalu sa t`i shoh,
Njerëzit e mi!

T`ia shoh në sy mallin,
Nënës sime plakë;
T`ia shikoj ballin,
Që i digjet flakë!

Nënës sime të mjerë,
T`ia lëshoj edhe një sy,
Se ndoshta kur të kthehem,
E gjej nën dhe të zi!

Mbi varr të saj atëherë,
Mund të mbij bar,
Por sytë e saj nuk mbyllen,
Djalin pa e parë!

Trupi i saj në varr,
Mund të kalbet e tretet,

Por në zemër i pashuar,
Malli do t`i mbetet!

Ndalu t`i them gruas:
Nuse lamtumirë!
T`ia fshij nga syri,
Lotin që i ka ngrirë!

Se po e lë vetëm,
Po e lë të ve,
Nga malli të tretet,
Të mplakët e re!

Do të rrojmë së bashku,
Më thoshte vajzë dikur,
Të lumtur e të dashur,
Pa u ndalë kurrë…!

E tani kështu çdo dimër,
Më thotë „Udha e mbarë!"
Me të vetmin urim:
Kthehu sa më parë!

Ndal, e mos shpejto,
Mor ti tren e zi,
Ndalu sa t`i shoh,
Fëmijët e mi!

T`i shoh edhe një herë,
Dhe ata të më shohin
Se ndoshta kur të kthehem,
S`i njoh e s`më njohin!

Zemra e tyre e njomë,
Mall e mërzi plot;
Bukë kurbeti në sofër,
Të njomur me lotë!

Oh, ndalu, tren i zi,
Mos shpejto kaq shumë,
Se zemra po më digjet,
Po më bëhet shkrumb!

Ndalu edhe pak,
Mor lugat i zi!
Tokës sime të dashur
T`ia lëshoj edhe një sy!

Ta shikoj Kosovën,
Të shkrehur në vaj,
Qan Kosova Nënë,
Qan për bijtë e saj!

Male dhe lëndina,
T`i shoh dhe një herë;
Ara dhe bashtina,
Të mbetura djerrë!

Ta ndiej flladin e malit,
Aromën e ugareve;
T`i shoh njerëzit e gjakut,
Dhe varret e të parëve…!

Lamtumirë Kosovë,
O Toka ime e shtrenjtë!
Lamtumirë Kosovë,
O Nëna ime e shtrenjtë!

Ty shpinën po ta kthej,
Dhe fushave të tua;
S`i  s`pati, vallë, këndej
Një kafshatë bukë për mua!

Çdo hap në këtë truall,
Ari dhe flori;
Vallë nuk paska bukë,
Për fëmijët e mi?!

Ti Tokë e bekuar,
Çdo pëllëmbë pasuri;
Si s`paske bukë për mua
E punë për krahët e mi?!

Kope të tëra bishash,
Ushqehen me ty,
E unë biri yt,
Marrë botën në sy!

Nisem për në botë,
Nisem për shtegtime;
Por, këtu tek ti Kosovë,
Më mbetet zemra ime…!

Treni i zi si nata
Rrëshqet drejt veriut,

Digjet prush e flakë,
Zemra e kurbetçiut!

Pas mbetet Kosova,
Në acar e vaj;
Qan Toka Nënë
Qan për zogjtë e saj!

Shaban Çupi, fshati Paldenicë, Hani i Elezit

Dy herë i burgosur nga policia serbe dhe kam mbajtur 6 vite burg. Kam qëndruar në këto burgje: Gjilan, Prishtinë, Lypjan, Gurrakoc, Dubravë,(ku në burgun e dytë kam përjetuar edhe maskrën serbe ndaj të burgosurve shqiptarë ku janë vrarë 117 të burgosur e rreth 300 mbetën të plagosur) si dhe në burgun Nishit si peng lufte. Nga burgu i Nishit jam liruar më 10 gusht të vitit 2000.

Teksti u shkrua në muajin korrik, 2026

Botim elektronik në internet archive.

P.S.

Shkrime të tilla dokumentuese, qoftë si tërësi, qoftë të fragmentuara janë edhe në shkrimet e tjera dhe të gjithat i kam të botuara në formën digjitale në internet archive.